

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Hartimi i planit të Mbarështimit të ekonomisë pyjore ZallHerr-Priskë” në pronësi të Bashkisë Tiranë”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 77200000-2 Shërbime pyjore.

Vlera e Fondit Limit: **5.096.000 (pesë milion e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5;

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari percaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 11, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 12.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe shtojcës 11 të DST-së.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2019,2020,2021), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar..

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: "40% të vlerës së parashikuar të kontratës ne procedurat e prokurimit..... dhe ne procedurat e prokurimit "Shërbim Konsulence" si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare", si dhe në legjislacionin e fushës ne fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

2.2.2 Kopje të çertifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2019, 2020, 2021) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën

vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me shërbimet objekt i kontratës:

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencë të kategorisë III.7.A sipas shtojcës së ligjit për licencat, bazuar në pikën 3, neni 5, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë në përbërje të tij një staf pune të kualifikuar për hartimin e planit të

mbarështimit, me eksperiencë minimale 10 vjet në fushat respektive të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave, licensuar sipas legjislacionit në fuqi.

Stafi i kontraktorit do të ketë në përbërje specialistë të profileve si më poshtë:

- a) Të paktën 1 (një) Inxhinier Pyjesh, i cili do të jetë dhe kryetar i grupeve respektive të punës (i pajisur me "**Certifikate personale**", për shërbime profesionale për projekttime sipas gërmes (c) pika 1 e Rregullores Nr. 3, datë 08.07.2009, "Per certifikimin e shërbimeve të ekspertizës dhe profesionale në pyje dhe kullota").
- b) Të paktën 1 (një) Specialist Pyjesh (Inxhinier/Teknik i mesëm)
- c) Të paktën 1 (një) Inxhinier Topograf/ Gjeodet, i licensuar, (i pajisur me licencë profesionale individuale "Projektues Gjeodet", Kategoria 8.E, sipas lidhjes 2 të VKM nr. 759, datë 12.11.2014 "Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit dhe projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim", i ndryshuar, lëshuar nga Institucionet e autorizuar për lëshimin e licencave).
- d) 1 (një) Biolog
- e) 1 (një) Zooteknik/Veteriner

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin provues si më poshtë vijon:

- Eksperienca e punës dhe profilet e specialistëve duhet të vërtetohen nga ana e operatorit ekonomik me kontratat individuale të punës (te vlefshme gjatë kohës së hartimit të planit), kopje të librezave të punës, kopje të diplomave, jetëshkrimet (CV) si dhe çdo kualifikim tjetër profesional.

Të gjithë anetarët e grupit të punës, do të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të hollësishme duke u mbështetur në Manualin e Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me Nr.864 prot., datë 30.01.2019.

Kriteri 2.3.3 dhe nën pikat e tij do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 12, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4 b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Konkretisht:

Neni 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", pika 4:

[...Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...] VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Neni 41, pika 4.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin provues si më poshtë vijon:

- Eksperienca e punës dhe profilet e specialistëve duhet të vërtetohen nga ana e operatorit ekonomik me kontratat individuale të punës (te vlefshme gjatë kohës së hartimit të planit), kopje të librezave të punës, kopje të diplomave, jetëshkrimet (CV) si dhe çdo kualifikim tjetër profesional.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa për staf është e nevojshme për të garantuar Autoritetin Kontraktor se OE disponon kapacitetet me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen.

Numri i përcaktuar për secilin specialist është përlllogaritur, duke marrë në konsideratë proceset, veprimtaritë apo shërbimet që përfshihen për realizimin e kontratës dhe është në përpjestim me natyrën, përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe limitet kohore të parashikuara për të përfunduar këtë kontratë.

Konkretisht: Argumenti për stafin:

a) Të paktën 1 (një) Inxhinier Pyjesh, i cili do të jetë dhe kryetar i grupeve respektive të punës (i pajisur me "**Certifikate personale**", për shërbime profesionale për projekte sipas gërmes (c) pika 1 e Rregullores Nr. 3, datë 08.07.2009, "Per certifikimin e shërbimeve të ekspertizës dhe profesionale në pyje dhe kullota").

Inxhinieri i pyjeve i certifikuar do të koordinojë dhe mbikqyrë veprimtarinë ditore në terren të grupit të eksperteve që do të hartojnë planin e mbarshimit të pyjeve.

Inxhinieri i pyjeve duhet të jetë i licensuar/certifikuar nga Ministria e Mjedisit në përputhje me Rregulloren nr. 3, datë 08.07.2009 "Për certifikimin e shërbimeve të ekspertizës dhe profesionale në pyje dhe kullota".

b) Të paktën 1 (një) Specialist Pyjesh (Inxhinier/Teknik i mesëm)

Asiston dhe shërben për realizimin e studimit në terren të përshkimit sipas ngastrave e nënngastrave, nëpërmjet marrjes së sipërfaqeve provë për të saktësuar përbërjen e grumbullit pyjor, volumin, masat e parashikuara për kryerjen e punimeve të ndryshme për periudhën 10 vjeçare, etj.,

c) Të paktën 1 (një) Inxhinier Topograf/ Gjeodet, i licensuar, (i pajisur me licencë profesionale individuale "Projektues Gjeodet", Kategoria 8.E, sipas lidhjes 2 të VKM nr. 759, datë 12.11.2014 "Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit dhe projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim", i ndryshuar, lëshuar nga Institucionet e autorizuar për lëshimin e licencave). Kryerjen e matjes së sipërfaqeve në terren, sipas ngastrave e nënngastrave, hedhjen e tyre në hartat përfundimtare të planit të mbarshimit.

d) 1 (një) Biolog

Kryen studimin dhe inventarizimin e bimëve mjekesore, aromatike dhe tanifere sipas ngastrave e nënngastrave pyjore etj.

e) 1 (një) Zooteknik/Veteriner

Shërben për studimin dhe përcaktimin e faunës së egër (kafshë dhe shpendë), që ndodhen në zonën

pyjore ku do hartohet plani i mbarështimit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike (termave të referencës):

Termat e referencës/ Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Objektivi i përgjithshëm i Planit të Mbarështimit duhet të jetë menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve pyjore/kullosore në pronësi të Bashkisë Tiranë (edhe nga këndvështrimi ekologjik), me strukturë dhe cilësi të mirë në përshtatje me kushtet e zonës dhe në përputhje me objektivat e mbarështimit.

Objektivat specifike të Planit të Mbarështimit të pyjeve dhe kulotave, do të jenë:

- ◆ *Përcaktimi i përdorimit të territorit në përputhje me gjendjen lokale dhe nevojat.*
- ◆ *Optimizimi i formës së qeverisjes në përputhje me nevojat lokale, mundësitë e grumbullit pyjor dhe mjedisit për të përmirësuar prodhimtarinë.*
- ◆ *Optimizimi i funksioneve ndërmjet nevojave dhe mundësive ekologjike/silvikulturale në përputhje me rëndësinë multifunktionale, sociale dhe mjedisore të pyjeve.*
- ◆ *Përmirësimi dhe mirëmbajtja në një gjendje të mirë funksionale të grumbujve pyjor.*
- ◆ *Rritja e prodhimtarisë së pyjeve me funksion prodhues.*
- ◆ *Përmirësimi i cilësisë dhe gjendjes së grumbujve të trungishteve me funksion prodhues.*
- ◆ *Nxitja dhe përdorimi i ripërtëritjes natyrore sa më shumë që të jetë e mundur me qëllim që të krijohen ekosisteme pyjore që i përshtaten mjedisit.*
- ◆ *Pakësimi i impakteve negative në gjendjen fitosanitare të pyjeve dhe prerjeve të paligjshme.*
- ◆ *Rehabilitimi dhe garantimi i rritjes së qëndrueshmërisë të prodhimtarisë në sipërfaqet pyjore/kullosore.*
- ◆ *Sigurimi i pjesëmarrjes së gjërë të popullsisë lokale në marrjen e vendimit për menaxhimin e pyjeve/kulotave.*
- ◆ *Përmirësimi i menaxhimit të pyjeve duke lidhur resurset pyjore/kullosore me interesat e përdoruesve.*
- ◆ *Menaxhimi i punës për hartimin e planit dhe futjen e tij në Sistemin e Informacionit Shqiptar në Pyje (SISP).*
- ◆

Hartimi i PMPK duhet të bëhet bazuar në parimin e mbarështimit të qëndrueshëm që nënkupton "të ruajë dhe të forcojë gjendjen shëndetsore të ekosistemeve pyjore për një afat kohe të gjatë dhe në të njëjtën kohë për të siguruar mundësi ekologjike, sociale, ekonomike dhe kulturore për mirëqenien e brezave aktuale dhe atyre të ardhshëm". Ky plan hartohet për ekonominë pyjore që është pjesë e Bashkisë Tiranë dhe natyrisht në kordinim edhe me njësitë e tjera ekonomike fqinje apo zonat e mbrojtura nëse është e nevojshme.

Hartimi i Planit të Mbarështimit është një mjet për të njohur gjendjen aktuale të territorit, siguron një ndërveprim me aktoret dhe Bashkinë si dhe kordinim me institucionet qëndrore nëpërmjet përdorimit të Sistemit të Informacionit Shqiptar në Pyje (SISP) dhe kjo duhet të ndodhë gjatë hartimit të PMPK dhe gjatë drejtimit të ndërhyrjeve dhe ngjarjeve në periudhën e vlefshmërisë së planit.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimitisht miratimin e dokumenteve të tenderit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Hartimi i planit të Mbarështimit të ekonomisë pyjore ZallHerr-Priskë” në pronësi të Bashkisë Tiranë**”, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

Dokumentat e tenderit;

Termt e Referencës

NJËSIA E PROKURIMIT